URDHËR
Nr. 172, datë 16.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH NGA KRYETARI I AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT TEK SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 9/1 të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar; neneve 22, pika 3, 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar; ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar; vendimit të Kuvendit nr. 95/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"; nenit 73, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për përcaktimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar; neneve 11, 40, 48, pika 3, të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.2.2024, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; nenit 4, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator 'Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve'",

URDHËROJ:

1. Delegimin te sekretari i përgjithshëm i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, znj. Sofi Noti, të:

a) ushtrimit të kompetencave, funksioneve dhe përgjegjësive të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për organizimin, ndjekjen dhe realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik të institucionit, në përputhje me legjislacionin e prokurimeve;

b) menaxhimit dhe kontrollit të riskut, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, si dhe akteve të dala në zbatim të tij;

c) funksionin e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike gjatë fushatës zgjedhore, sipas përcaktimeve të gjendura në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të

ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", të ndryshuar;

d) ushtrimit të kompetencave ligjore dhe të funksioneve të zbatimit të programit të transparencës, siç ato përcaktohen dhe parashikohen në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar;

e) përcjelljes së informacionit dhe dhënies së dublikatave në zbatim të ekzekutueshmërisë së vendimeve të marra nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në rastet kur ky informacion mund të jepet brenda masës dhe parashikimeve ligjore;

f) përfaqësimin dhe ndjekjen e çështjeve me karakter administrativ që lidhen me veprimtarinë e sekretariatit teknik dhe të stafit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të tilla si, shkëmbim informacioni apo ndjekje e procedurave të rekrutimit të stafit.

2. Ky delegim kompetencash vlen për një afat të pacaktuar dhe mbaron vetëm me revokimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet sekretari i përgjithshëm, znj. Sofi Noti, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Të njihen anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me këtë urdhër.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gentiana Sula